# DËSHMI ARKIVI

**A-440600**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Valë e re turistësh në Durrës, vizitorë nga Europa zgjedhin shtatorin për më shumë qetësi, operatorët ankohen për punonjës \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/vale-e-re-turistesh-ne-durres-vizitore-nga-europa-zgjedhin-shtatorin-per-me-shume-qetesi-operatoret-ankohen-per-punonjes/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 18:56:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 14:25:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8cdaa99852d7358f33d7adfbd2918f7fb2de237b8bb1ddce51c30bdbf2635dba` |
| TEKSTI | `a425f6aca9491fc761f6c217db2fb089e02b47867b60f1aae9f730a1189b4859` |
| PAMJA | `3ef989f52c663ee2e30d436cd540cc6297e110ca3f79ddbf4c51733393ccac96` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `90b98f428bab5226c80860e772b46b92208ac9f31ccb952ea0ddf994b6219acc` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/90b98f428bab5226c80860e772b46b92208ac9f31ccb952ea0ddf994b6219acc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Valë e re turistësh në Durrës, vizitorë nga Europa zgjedhin shtatorin për më shumë qetësi, operatorët ankohen për punonjës

*Edi Hallaci*

*13 Shtator 2026*




Sezoni turistik nuk mbyllet me fundin e gushtit në Durrës.

Fillimi i vjeshtës ka sjellë një valë të re vizitorësh nga mbarë **Evropa**, ndërsa prenotimet në strukturat akomoduese shtrihen deri në mesin e tetorit, duke e shndërruar vjeshtën në një mundësi të shkëlqyer për ta shijuar bregdetin pa fluksin e madh të verës. Për shumë të huaj, Durrësi dhe Shqipëria nuk është vetëm plazh, por një paketë e plotë me energji, aktivitete e argëtim.

"Erdhëm për shkak të motit, por edhe sepse dëgjuam për festat dhe muzikën afrobeats që bëhet në Durrës. Donim ta provonim vetë! Durrësi është shumë i këndshëm, moti është i shkëlqyer dhe njerëzit shohin punën e tyre", tha një turist.

"Përvoja është perfekte. Erdhëm dje, bëmë një nga festat më të mira të jetës sonë. Sot ka diell, ndaj po planifikojmë pak zipline dhe udhëtim me motorë quad. Shqipëria është një vend i vogël, por me shumë energji pozitive! Ndaj e rekomandoj Shqipërinë. Shijojeni se jeta është e shkurtër", u shpreh një tjetër turist.

Përveç atyre që kërkojnë festat dhe aventurën, shtatori tërheq edhe shumë familjarë dhe të rinj që shfrytëzojnë këtë periudhë për pushime më të qeta.

"Erdhëm për përvjetorin tonë dhe ditëlindjet tona. Kemi vizituar Tiranën, Shkodrën dhe tani Durrësin. Çdo gjë ka qenë e bukur, kemi bërë shumë gjëra", tha një tjetër turist.

"Është bukur këtu dhe ushqimi është shumë i mirë! Zgjodhëm shtatorin sepse pushimet shkollore në Austri janë tani, kështu që po kënaqemi", u shpreh një turist nga Austria.

Sipas përfaqësuesve të sektorit, ecuria e këtij viti ka qenë mjaft e mbarë dhe interesi për Durrësin

mbetet i lartë dhe përtej muajve tradicionalë të sezonit.

Përtej bilancit pozitiv, operatorët turistikë përballen edhe me sfida. Një nga shqetësimet kryesore të këtij sezoni lidhet me menaxhimin e punonjësve të huaj dhe marrëdhënien e punës me ta.

Teksa stina e vjeshtës hyn gradualisht, Durrësi vazhdon të mbetet plot gjallëri. Zgjatja e sezonit po konfirmon se qyteti bregdetar po i afrohet gjithnjë e më shumë objektivit për të qenë një destinacion turistik gjithëvjetor.


**LAJME TË NGJASHME**



Superjahti 450 milionë dollarësh i pronarit të Manchester City ankorohet në Durrës!
1 MIN



5 automjete të përplasura në Durrës-Tiranë, humb jetën 1 person!
1.5 MIN



Aksioni për parkimet në Durrës/ Zaptimi i hapësirave nëpër lagje, policia nis heqjen e pengesave të vendosura nga banorët
1 MIN



Kuvendi rikthehet në "betejë"/ Harta territoriale, testi i parë, PD paralajmëron ankesë në Kushtetuese dhe referendume
2 MIN



Përmbysje dhe histori, Ronaldo shënon golin e 978-të në karrierë dhe rrëmben fronin absolut në Arabinë Saudite
1.5 MIN

**MË TË LEXUARAT**



Flasin ekspertët/Gërhitja e partnerit nuk është thjesht bezdi, mund t'ju dëmtojë seriozisht shëndetin!




"Marshi për Liri" në mbështetje të ish-krerëve të UÇK, qytetarët nisin grumbullimin në Prishtinë



Para verdiktit, Kosova përcjell edhe njëherë mesazhin për ish-krerët e UÇK-së




Aksident në Selenicë, automjeti del nga rruga dhe bie nga një lartësi të madhe, humb jetën shoferi



Lady Gaga bëhet nënë për herë të parë



Bëni kujdes me këto shenja të zodiakut/Për të flirtuar i keni ‘ekspertë’ por për lidhje serioze, harrojeni!


Ilaçi që mund të rikthejë flokët te personat me alopeci të rëndë…


Shenjat e zodiakut që luajnë “viktimën” edhe kur kanë faj!


6-vjeçarja bëhet virale në rrjet, nis shkollën e vetme në fshatin me 40 banorë!


Daja para derbit me Partizanin: Do fitojë ekipi që do të bëjë më pak gabime, duhet të jemi gjithë kohës në ekuilibër!

## EDITORI SUGJERON


Një dietologe tregon si të hani karbohidratet, proteinat, yndyrnat dhe fibrat për të kontrolluar...


Çfarë ndodh me trupin tuaj kur merrni ekstrakt çaji jeshil me kafeinë?!


Studim/Hemoglobina e ulët mund të çojë në...


Shumë njerëz e bëjnë çdo natë, por studimi i ri tregon një rrezik të fshehur!


Dëshironi të rregulloni kolisterolin?! Këto janë frutat që ju duhen...


Mendoni se po veproni mirë, por me këto ushqime po dëmtoni...


Kujdes! Këto ushqime nuk duhet t'i përzieni kurrë me vitaminën D...


Vaj ulliri me hudhër është i shëndetshëm për organizmin?! Ja se çfarë ndodh në të vërtetë...


Proteinat bimore apot proteinat shtazore?! Ja se cilat janë më të mira...


A duhet të stërviteni ndryshe gjatë menstruacioneve?! Përgjigjja mund t’ju befasojë...

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms


JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.